



UNIVERSITÀ DELLA CALABRIA
DIPARTIMENTO DI LINGUE E SCIENZE DELL'EDUCAZIONE
LABORATORIO DI ALBANOLOGIA
UNIVERSITETI I KALABRISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVET DHE I SHKENCAVET TË EDUKIMIT
LABORATORI I ALBANOLOGJISË



Opere di Francesco Antonio Santori

a cura di

Vincenzo Belmonte

FRANCESCO ANTONIO SANTORI

KËNËKË [E PËSUOMEVET]

O ju çë kini zëmërën të njomë,
të but e besullore sa të thomë
së mundinjë e së dī, ndo mirrni vesh
me trū të hapta e shpirtin të nojtesh,
një storī ju rrëfienjë, cila ju tundën 5
zëen e shpirtin e fuqinë ju mundën.
Dua të ju thomë prë nē po sa dhuroi
Jesusi kur na bjejt e lefteroi
ka Pisa e ka mbëkata, e zghardhamend 10
Parrajsin neve bëri, e sa kutjend
na taksi qiellisht, e sa gadhnjeu
njeriu kur' ajo drit mbi dhë shkëlqeu.

DARKA

Prana çë thirkolisi Zoti Krisht
trī vjet, po të qëroj mbëkatjes misht,
e me urtrī e me mirakul mbjoi 15
qiellin e dhënë, e shpirtin e pastroi
me t' gjata penitenxje e agjërimi,
me lusa, metanī e me shërtime,
hera m' u qas të lëj gjellën dheishte
të hapij neve jetën qiellishte. 20
E ahiena Daskalerit mbë një vend
i mbjodhi, bashk me t' Ēmën, mbë kuvend.
Përpara, gjithvet këmbtë i lajti. Tha:
"Ulëtinë të ju porsinjë Tata më dha:
si juve bënjë u ni, të tjerëve ju 25
kīnë bëni, sa të jetë gjella këtu!".
Moj Pjetëri s' duoj i lajturë, e atij
Krishti zū t' i thoj e t' e porsij:
"Kush s' do të jētë i lajturë ni ka u,
qëndrōnë mbi dhë mbëkatëruorë kështu 30
sa pjes ngë kā ndë timen Rregjērī
e nëng e ruonjë me mallë e namurī".
Pjetëri kur' ashtu gjegji këmbën ngjati
e skamallisi shtrëmburin çë pati,

tue thënë: "Kur' është ashtu, triëmbli Zot, lajëm si do, nani e ndë gjith mot!".	35
Ahiena Krishti u ngre, e bashk me tjerë uli të haj ndë tries të gjat e gjerë, e, marrurë bukën, e thjejt e je bekoi e, shëjtëruorë, me të gjith i kungoi,	40
tue thëturë: "Buka kurmin timë buftënë vërtetëm e gjakun vera ju zbulonë. Pather çë hani asoj, kultohi meje e kamë ndë qiellë edhe një kred hareje.	45
Mbero nani ndë zëmërë kamë dhëmbime, se një ka ju më bënë një tradhizime".	45
Apostolit helmuorë thojin ka një: "Kurraj ja bënë u Daskalit këtë!".	
Moj Krishti u përgjegj e bënë e xënë se Judha ish i ligu kotikënë	50
çë prë turres e shitij e nodhë i mbaj, se kish me djallin amahj.	
Judha s' u ndikurua e, ngrënë e pîrë, duolli të vej, e Krishti më dulirë	55
Apostulvet i flit si jätë, e thoj Pjetërit, çë mbi gjith të xëj kërkuj:	55
"Mbë mua ju sonde skandalepsi gjith e, t' ikni nje me këmbë, ngini mbë vith".	
Po Pjetëri thirri: "Edhe se gjith ashtu të bënëjin, Zot, s' e bënëj prë fare u!".	60
E Krishti atij: "Moj ti çë taksën më, ti sonde m' arnjizënë prë faregjë.	
E kurë prë trëmbësīmë rremen besōnë, gjeli tuke kënduorë vërtenë kultōnë, çë të kamë thënë!". Ahiena Krishti u ngre,	65
muori liçenx ka e Jëma e vet me tre t' Apostulvet u nis, e t' Ęmës e mjerë drita ju spav, e shih nd' ato linerë mose gjak e ftira ligullore e pësuome të rënda e zezullore.	70

KOPSHTI JI GJETSEMANIT

Moj, ture mbëtë ajo ndë llaftari, Krishti me një trīmadhe merëngi te kopshti i Gjetësemanit arruri e Apostulit çë kish me të po i vuri të lusëin ndë një vend, e ai, tutje	75
i vaturë, rā mbë gjunjë, e lusi atje të Jatin prë një cop. I ngrëjtërë, vate te Daskalerit e m' i çoi ndë gjate qëlluome. Me namur i thirri e zgjoi	

e pra me ëmbëlsī pak i qartoi. 80

"Mos fjëni - i thoj - mos fjëni! Misht e rënd
kush gjegji, mīrë një herë prë fare u gjënd.
Bëni sa Shpirti thot, ndo duoni mīrë,
e lusëni, e parkalesëni të dulīrë!".

Vate të truhej t' Ātit ditën herë 85
e gjumi skallangurit Daskalërë
i mundi prë së diti, e kur' u pruorë
t' i shihij Jesu Krishti u patë helmuorë.
"Fjëji si duoni, - tha - tas erdhi hera
çë gjith mbi mua të murgun bie qinera, 90
e ji shkreturë ka gjith kām të dhuronjë
pa monu të thërres o të rëkōnjë,
se ti, Pjetërë, çë thë se mirë më donje
sa mëngu ndë vëdeqen më lëshonje,
nani monu një koh munde këtu 95
të lusnje bashk me mua si doja u."
E vate të lusoj të tretën herë
me parkales të gjate e keq të gjerë
të Jatin, po të mund e lefterosij
ka dhurimi ç' e trëmbij e kanosij. 100
E pati ahiena atje mbë zëe dëmbimë
të thelle ashtu, sa, i zgjidhurë mbë dërsimë
të gjakullore, ndruollë me faqe rā,
si burr i pafuqī prë gjak çë s' kā.
Ahiena pati qielli lipisī 105
e nj' Ēngjell i dërgoi me anangasī,
ka cili Krishti i ngrëjturë e i levruorë,
të tretën herë te Daskalërët u pruorë.
Po të qëlluorë i gjeti e i skotisi,
tue thënë: "Via, zgjohi, anangasi, nisi! 110
Së shihni Judhën po si ngrah më vjenë
me t' armatosurë murr, si turburë qenë?".
Ai monu kish serpos t' e thoj e nje
Judha çërëzī ju fanaros atje.
E tēfali si mik e llōrētë i shtū 115
ndë xerk e buzën ndë sij buz i vū.
Krishti ng' u llastimis, po vet i tha:
"Çë vjenë me thënë kjo punë? Çë janë këta
shërbise çë më bënë, o Judh, mik imë?
Më puthën e pra më shtie ndë tradhizimë!". 120
Judha s' përgjegji e u llarghua, se kish
thënurë Çëfutvet kur i fōl ndë Qish:
"Atë çë puthinjë u, rrëmbeji e mbani,
lidhn'je me rē, e nje prej horën ngani,
ndomos, magharë si është, ju e kallonë 125
e si një ngjal prë duorvet ju shpëtōnë".
Ata, porsirë ashtu, ju sulëtin ngrah,

e patin kurë se më kush mund e rrah.
 Jesusi ahiena e tha vetëm një fjal,
 ç' i bumbliti mbë vesh si gjëmë ndë mal. 130
 U gramistin prë trolli e të zmarmaturë,
 të verbërë, të tramaksurë e t' çotjasurë,
 inë prej të disën, kurë Jesusi atire,
 me çerën të përラムsurë e dulire,
 i thoj: "Me nxërr ashtu erdhtit mbi mua, 135
 si mbë njeri ç' armik më ju zbulua
 o si t' isha vjedhtarë e burr vrasorë.
 Moj thoni prë sa herë më patë ndë horë.
 Ndë Qisha, prë ndë udha e anamesa
 nd' aghora thirkolisa e ka fëtesa 140
 ju thirra, e nëng më bëtë ahiena gjë,
 e ni ka u i meruorë çë doni më?
 Mbero, ë hera juoj, bëni çë doni:
 njota se jam u ai po çë kërkoni".
 Ata, si qenë të rrahurë, më me dīrë 145
 u ngrënë, e m' e rrëmbienë atë dulirë
 qëngjith i but çë vej ndë vuçari
 pa të rëkoj o shtij një thirm. U shpī
 ahiena një t' Apostulvet e holqi
 një kopanë mahjerje, e veshin tolqi 150
 një Judhiu ç' e lidhij. Moj shpëlqeu
 shërbesi Jesu Krishtit, e këtheu
 të qartoj Daskalerin, e atij
 veshin shëroi, e tuke thënurë vij:
 "Vëni te milli thikat, se ju s' dini 155
 të njihni jo ku veni e jo ka vini.
 Po si s' kultoni se kush bie me thik,
 ka thika është i vrārë? Mangoj një pik
 të digjij gjith këta, ndo doja u?
 E Tata së m' dërgoj njëmend këtu 160
 ëngjëllore llojë sa më të donja,
 sa me një fjal po vetëm t' e lutojja?
 Ni hera është e Pisjes, e, mos vete
 u, jeta gjith qëndrōnë errsuorë e shkrete.
 Leni të bënjin poka sa të duonë, 165
 se ashtu do qielli edhe!". Fōrt e shtrënguonë
 Judhijtë ahiena, e Daskalerit vānë
 e Daskalin nd' armiq të zënë e lānë.

TEK PLLASI JI KAJFASIT

Judhijt' ashtu të lidhurë e shtrënguorë,
 të rrahurë, të gërvishturë e dëmtuorë 170
 ndë kurmin gjith Jesusin, parë tek Ana
 e qelltin, të m' i shkruhej zez kundana.

Ana së desh t' e bënej e dërgoi
 Jesusin te Kajfasi, tek arvoi
 sa monu e ai njeri ç' ish prift i madh 175
 u vū t' e pienej dal e dal mb' aradh:
 "Po thuojna neve ti, thuojna ndë jē
 i biri tinë Zoti, po si thē
 e para tij e thanë këta martri,
 si ti gjegje me vesh e pē me sī". 180
 Moj Krishti ju përgjegj: "Ti vet e thē,
 e u të thomë, se ju names ndë rē
 kënë shihëni po si vjenë pra kī njeri
 me drit e me trīlarte madheshti
 të judhikonjë të ligun e të mirin, 185
 e të paguonjë si jātīn po të birin,
 e gjithnjeri prē dreq si meritōnē
 ndë Pisën o ndë Parrajsin m' e dërgōnē".
 Prej Krishtit nd' ato njerz ç' ishin atje
 rrij Mallku, ç' ish gjērī t' atij edhe 190
 kuj me mirakull veshin Krishti tëri
 e, prē të ligën ç' pātē, mirën i bëri.
 E kurë Jesusi dreqten ashtu foli,
 Mallku me nxër përpara çērës i doli
 e me një dorë të hekurme e të rēnde 195
 i dha një kopanē ndë faqe, "Gjēnde
 - tue thēnē - përpara priftit i mbēdhā
 e ashtu përgjegje? Shih t' e bēç papā,
 se pa dhēmb e pa buz të tërē qēndrōnē,
 tas çē ka fjal ti një mallkīm dërgōnē!". 200
 E Krishti ju përgjegj: "Çē bëra u?
 Mē rē pse vërtetēn thash këtu?".
 Moj Kajfasi me dīrē ahiena shquori
 të veshurat, e lart të thirrij muori,
 tue thēnē: "Çē vemi mē tue gjēnē martri? 205
 Së gjegjitit ju po si mallkoi ni kī?
 E gjith me vet një thirmē e një penxērē
 përgjegjtin: "Ësht i lig e kā të vērē,
 si meritōnē, të des mbi kriqe i vjerr,
 i lakosurē, përgjakurē e ji shqerr!". 210
 Kajfasi thoj: "Mbero së mundmi na
 t' e vrasēmi, se po ditat janë këta
 të Pashqēvet". E, të mbjedhurē mbē këshillē,
 penxuonē si kesh t' errsojin bardhin illē,
 e tek Pillati lidhurē e dërguonē, 215
 moj me padhī të rēnda m' e shokuonē.

PRETORI JI PILLATIT

Pillati, kurë e pā atje names,
ndë çērën e njohu dreq i safëtes,
e thoj Judhive: "Ju ka kī çë doni?
Çë bëri kī njerī ç' ashtu e tratoni?" 220
E ata përgjegjtin: "Thirkolisi e tha
gjithkūnë se Rregj një hērë të jētë, e na,
të xëjim mbë vërtet po si shërbesi
vete mē thellë, e kī nëng është namesi,
i vamë prë nënë, e ai na kallëzoi 225
se Theosi ka qielli e dërgoi
të thirkolisinjë e zotronjë. Ni ti
judhikoje prë dreq ndo është ai
Theos e Rregj, e njeh se ç' është i rrëmi,
pse na jetërë Rregj s' duomi të kemi 230
se Qesarin të vet; e mosnjerī
me Qesarin ka liq e amahji,
ndo një'tërë burr prë rregj të ruonjë o shoh
o një'tërë potestat mbi dhë të njoh".
Pillati ndë kto fjal u adunārë 235
se prë vidhje Judhītë e duojin vrārë
të birin e Theosit, e vū rë
mbi shërbesin trīshūmë, e shoqja edhë
i thoj të mos e vrit, se burr i mīrë
ish e Profet ai njerī fanmirë. 240
Pillati bëri shumë t' e lefteroj,
moj gjindja mē thërrit se vrārë e doj,
si burr i lig çë meritoj të disij
e vëdeqen ndë kriqen kesh t' e prisij.

PËLLASI JI ERODHIT

Pillati gjegji ahiena se dica 245
e thirrjin Ghallillë, e muori e tha:
"Ndo është kī Ghallillë, s' e mundinj' u
t' e dëmëtonjë, se rregji është këtu
i Ghallillës". E, thën' ashtu, e dërgoi
tek Erodhi të vej, e, kurë arvoi, 250
Erodhi me fjal t' ëmbra shumë e mbjodhi,
e kurtja gjith të shihij Krishtin rrodhi,
e suldetia përpara gjith i doli.
Moj Krishti nëng e fali e nëng i foli.
Erodhi prë të llavurë Krishtin mbajti 255
e nëng i bëri dëm, po vet e shajti.
E bashk me sijin zot gjith u përzia
gjindja të rregjërīs e bulëria.
E tas çë mbë të bardha e pānë të veshurë,
e pruortin tek Pillati tue përqeshurë. 260

TEK PRETORI

Pillati kurë ashtu pastruorë e pā,
Judhivet muor' e foli ai papā:
"Ju shihëni si po Erodhi mëngu deshi
t' e dëmij, po sa vetëm e përqeshi.
E të veshurë bardhërisht si m' e dërgoi, 265
mirinë e paftesinë të tij buftoi".
Ahiena pjonu dīrë gjindja thërriti:
"Erodhi nëng e njohu e nëng e diti,
ndomos ng' e lëj të gjallë këtë njeri,
magharë i liq e pjonu rremësi!". 270
Pillati, i ndërlikurë e i çotjasurë,
udhën t' e lefteroj po vej tue masurë,
e thoj Judhive: "Na ndë filaqī
kemi një vjedhëtārë, çë vrau e u nxī
me gjakun e të shokvet, e ndë hōrë 275
bëri një rribeljon. Ni lefterorë
ndë Pashq kēmë bēnjēmi një: çë doni ju,
Barabën o Narenin ç' është këtu?".
Po thirrëtin gjith: "Barabën leftero
e Naxarenin nje të des dërgo!". 280
Pillati, ji shtrënguorë vendeshi gjith
si mushku çë ndë xerk njera mbi vith,
përpara s' dij të vej o të qëndroj
e Krishtit mjerë lëngimet i gjatoj.
Penxoi ahiena, po të mund e nxīrë 285
ka duort e t' aso gjindëve pjonu dīrë,
t' i jipij me frushërë një korrecjon,
prana prë fānë e tij të m' e dërgōnë.
Judhītë sa ndienë këtë patin hajdhī
e Jesusin rrëmbierë me anangasī 290
tek Pretori proposh afërë te dera
m' e xarristin e qelltin, me di hera
m' e xheshtin, e të lidhurë tek një stīllë
të marmuri, çë gjëndej nd' at kurtīllë,
me trëkuza, me tele e trasha dëllë 295
e rrahtin aq, sa rrij të bij pa gjëllë,
se mbi atë kurmë pa mos një kondrë o rē
shkrakuonë po kopaneshi një llojë
pa njehunī, e je përgjaktin gjith
çë ndë malez të kries njera ndë vith. 300
Të sjelurë prana lart e kuroruonë
me gjëmbe, e kreun mbarë e ballt' i shpuonë.
Të veshurë mbë të kuqe, me ndë dorë
një kallmë të lidhurë po si shëng rregjorë,
i bijin llofa, e rreth i vejīn nënë 305
tue pushtīrë, tua sharë e ture i thēnë:

"Godi vërtet, ndo se profet ti jë,
kush t' e mbërtheu nani një kopanë?".
E, tue kumbisurë ndruoll të mënçrin gjū,
i thellojin kurorën me një hū. 310

KRISHTI BUFTUORË BURR

Nd' ato gaze çë bëjin e rraptimë,
shtrushe, përqeshëme, thirmë e trokollimë,
rodhi Pillati e kurë çë Krishtin pā
si ka ulqit i shqerr një butith kā,
gjegji ndë zëmërë madhe lipisī 315
e keq ju ndot e thelle ajo ligrī.

Nje trūve i vate se, ndo buftoj
ashtu të bënë, edhe gurt' i ndërroj.
Ju qas ai përrëz, e ruojti, e muori
prë krahu e ka një lloxh prë jashta e nxuori, 320
tue thënë: "Njota njeriu çë doni vrārë,
çë thirrëni kurë Theos e kurë magharë,
e rregj e thirkolërë. Shini si e bëtë,
se monu njihet ç' është. Ndo se të gjëtë
shëndet, mirakull është. Len'je të verë 325
nani prë fanë e tij i lefëtërë!".

Dielli fshehu faqen nd' at fëtirë
e hëna u buftua je vrërë e nxirë,
moj populit ng' u tund zëmra një çik
e, po si mali monostrof e pik, 330
me një gjëmimë të lart thërriti e tha:
"Të vrārë, të vrārë mbë kriqe e duomi na!".

"E rregjin tëj ju vras?" - Pillati thoj,
kurë gjindja ju përgjegj po t' i rīthoj:
"Na s' kemi jetërë rregj, mëret o zot 335
se Qesarin mbi nē, e ti, ndo sot
këtë se të vëdes nëng e dërgōnë,
se nëng je mik me Qesarin buftōnë".

Pillati, kurë çë gjegji kët ndonat,
ënd e fuqī t' e lefteroj së pat, 340
moj i tramaksurë si pa liq e trū
të lahej para gjith me duorë u vū,
tue thirrurë: "S' kamë një pjes u ndë ktë gjak,
çë derdhëni ju të paliq, jo shumë, jo pak.

Kī burr i mjerë, i dreqtë e pafëtes,
si duoni ju, ndë kriqe le t' vëdes!". 345
Ahiena me një thirmë të gjate shumë,
si kurë ka larta brinja bie një lūmë,
thërritin gjith: "Kī gjak të bjërë mbi nē,
pikaz i ndarë e i shprishurë, se kā hję
mbi krerat [t]ona e mbi të bilëvet [t]ënë, 350

ç' as jënë, e kanë harë po kurë t' e xënë!".
 Pillati njohu drej se s' bënej gjë
 e s' desh të ngjatij ato straxje më.
 Shkruojti sendenxjen ndë trī gjuha e tha 355
 ndë kriqen të vëdis, si dōnë ata:
 "Jesusi Naxarënë, Rregj i Judhevet,
 vëdektë i vjerr mbi kriqen, po si Ebrevet
 vëlema duonë e nomi". Moj, kurë panë 360
 e mirë e dhjavesetin ka gjith anë
 të shkruome ashtu dëmtuomen, s' i pëlqeu
 e nje një pjes ka gjindja po kërceu
 tek Pillati tue thirrurë:" Mos e shkruoj
 "Rregj i Judhive" e burr i lig e thuoj!".
 Ahiena u llastimis atje Pillati 365
 e t' i dhuroj paçenxje më së pati.
 Me nxërr u prurorë e atire thoj me dīrë:
 "Çë duoni më ka kī ji sfanëmīrë?
 Si shkruojta, mirë e shkruojta, e faregjë 370
 dua dī ndo është mëret, o rregj o më.
 Ngini këtena e mos më thani trūtë,
 se keq prë nënë si arazit m' u vūtë".

KRISHTI ÇË VETE NDË KALLVĀRĒ

Ahiena me një shpejte anangasī
 i bënë një rēnde kriqe e Krishtit zī
 ja vunë mbi mushqe po t' e qellë edhe 375
 me dhurime të madhe njera atje,
 ku kesh t' vëdis. Ajo mbëshuome i mundi
 pakën fuqī çë kish, e gjith i tundi
 eshtrat e dellëtë, e i murgu vate rā
 trī herë, si ndën zigua varesurë kā 380
 i lodhurë e i lakosurë rënd po bie.
 Moj Çëfutit pa zëmrë o lipisie
 e shpitin, e xarrisëtin e i rānë
 ashtu sa pak gjëllij. Mbero, kurë pānë
 se udhes mund vëdis pa të rrëvoj 385
 te maleza e Kallvarit, rūonë se shkoj
 një burr i udhëtarë thënurë Simōnë
 e je shtrëngūonë t' e ndihij njerë t' arvonë
 ndë Kallvarin, e, vaturë më përpara,
 ju fanaruan ca grā me gjate qara, 390
 tue lipisjarturë Krishtin. Moj ai
 përgjegji atire: "As qajni jo nani
 e faregjë prë mua, po lotëni edhe
 mbi tëjën vetëhënë, e më tutje,
 se vinjin mote kurë të thirrëni shumë 395
 prindit çë s' patin bil se qenë të lumë.

Se ndo nani mbi arvurin të gjallë
 japën ligrie këtë përthellë sinjallë,
 çë të bënjin pëstaj mbë thatin drū,
 çë djeg si kallm' i mbrazt' e i pa trū? 400
 Maleve thoni ahiena 'Ju mbi në
 gramisi të na shtipni ndë ktë dhē!'.
 I tha e paravate, moj i shtiturë
 rā prë të ditën herë, e tue thërriturë
 Judhītë si mbal katrëmbi ç' është i raturë 405
 e ngrëjtin tur' e rrahurë, moj, sa vaturë
 ish pak përpara, ju përpoq e Jëma
 e drita ndë mezdrit ju err si mbrëma
 e zez e thellë, kurë sajın Birë prosteksi
 të bërë ashtu e atij edhe m' i reksi 410
 zëmëra kurë të Jëmën ruojti e pā
 e ahiena prë së treti vate rā
 para së Jëms. Moj prë nënë ju bē
 një rreth Judhīsh e nëng e lānë të gjē
 e Jëma mun t' i thoj, more dirisurë 415
 e strostin llarghu asaj tue xarrisurë
 Jesusin prej të dis. Mbero një grua
 lipisjare e je doqe u buftua.
 Përhapi rroqen e prë mbrënda u stros
 e Krishtit nje përpara u fanaros. 420
 Çerën me skemandil i pati shiturë
 e ftira i qëndroi atje je mbiturë.
 Skemandilin Verōnka prë sinjallë
 e mbajti sa mbi dhē qëndroi e gjallë.

RAHJI JI KALLVARIT

Mberrijturë mbë serpos tek ish Kallvari 425
 e xheshtin xhakaranë e prë së pari
 mbi kriqe e shtruonë me nxërr e me nodhī
 e prana, pa thërrimez lipisī,
 e gozhdjastin mbë të me këmb e duorë
 sa kesh të atje vëdekurë kish qëndruorë. 430
 Moj namuri të njerzvet gjallë e mbajti
 e gjellën gjith një herje nëng ja çajti,
 se kallaçin të tharturë kesh t' e pij
 kulluqez pas kulluqez, po të vij
 ndë serposën çë lus e dishëroj, 435
 me sij psimë njerinë të lefteroj.
 E ngrëjtin prana lartë ashtu gozhdjaturë,
 sa jeta, kurë e pā, u pātë skazaturë.
 Gjaku mbi ta, si shī i gjerë e i but,
 u shprish. Po ligullorë dica Çëfut 440
 ndajtin ndë ta të veshurat, po një

ish çë së mūn të shqirej, e mbi të
 shkurqën e shtūnë, t' e mirrij kuji ngit.
 Po hera ish ahiena prej mjezditë,
 sa Krishti alartaz thirri se kish ët 445
 e nje rranguonë dica asoj sëldet,
 përziejtin ndë një nekue uthull e mirr,
 e t' ëmbël e thartirë, e ture thirr
 ngjejtin një sponx e mal një kallm' e vūnë
 e prë ndë labra, t' e dëthij, ja shpūnë. 450
 Krishti e prëvoi sa monu e nëng e deshi,
 e bulëria judhë më e përqeshi.
 Ahiena me një lus të thellë të thellë
 thërriti Atin Krishti: "O Ellë, o Ellë,
 si më lëshove ashtu ndë këtë njëmend, 455
 i shqerrurë e i lakosurë ndë ktë vend?".
 Mëria me tjera grā lëngoij prë ndën
 kriqes tue qārë, moj jo një thirmë të bënë.
 Janji, ç' e shokëroj, i rrij ndë tal,
 e Krishti, ture i parë ka kriqja mbal, 460
 thonej të Jëms: "Njota biri jit!",
 e Janjin i buftoj, e zëen i prit.
 E, prjerrurë daskalerit prana thoj:
 "Njota jot' ëmë!", e t' Ëmën i buftoj.
 E ç' aso herje Janji e pat prë jëmë 465
 e mbë Janjin ajo qe neve mëmë.
 Judhītë me Zotin Krisht vuortin edhe
 di vjedhtaroth të ligj, e njeri atje,
 kurë pa Jesusin se kështu dhuroj,
 pa bënurë gjë, u pruorë e jatrit thoj: 470
 "Na bëtīm ndonjë të shtrëmburë e të liq
 e vete dreq nani se desëmi ngriq.
 Moj kī meruorë dhurōnë pa një fëtes
 e, po si thot, të na sallvonjë ai des".
 Moj shoku s' desh t' e gjegjij e u pruorë 475
 së jatrës ānë me faqe, e i pari muorë
 të lusij Zotin Krisht me madhe bes
 e Jesusi u përgjegj: "Ndë qiell të pres".
 Judhītë, çë s' dijin çë të bëjin më
 të shtijin atë drit mbë faregjë, 480
 thërritin një të verbërë, cili ngau
 me lënxi, e thellë ndë brinjëz ja këllau.
 Lënxa ja shquorë, e dreq prë mbrënda shkoi,
 njera çë gjeti zëmrën e ja shpoi.
 Atena uj e gjak shtëllloi si shī 485
 e ndriti atij të zezen verbëri
 të zëmërs e të sivet, e, kurë njohu
 se ç' ish ai, u metanos, e ngrohu
 e ngjallëti zëen e tij me bes të rë,

e bashk me të mbë qiell ni kâ harë. 490
 Ahiena Zoti Krisht me zae të lart
 thërriti: "O imi Jâtë, këta të thärt
 çë më vrasën, çë bënjin fare dînë,
 e kanë të kënë ndëleme, e lipisinë
 po tënde meritonjin: jipja ti! 495
 E mbë duor[t] tënde u kutjend nani
 shpirtin e vë!", e, ture thënë ashtu,
 me thirmë e një shërtimë ç' u ndie gjithku,
 vëdiq ... Një shkundullime e madhe e madhe
 skotisi male, llaka, sheshe e aradhe, 500
 përtundi dejte, e shkundalisi dhënë
 ndë vende gjith. Prë helëm e madhe pënë
 si dielli u nxī, po hëna u gjakullua
 e gjithia mbë të zeza u pastrua.
 Profetit, ç' inë ndë gropa, nd' atë rraptim 505
 u ngjalltin e rranguonë Jerusallim,
 e, kurë mbal kriqe Zotin dekurë panë,
 prë helëm' e prë dhëmbimë ndë truollin rënë
 të vëdekurë papā e më s' u ngrënë.
 E Zoti Krisht, çë tue vëdekurë dhënë 510
 sallvoj, qëndroi mbë kriqe prë di ditë,
 kurë Zepa e Nikodhemi drej u shpit
 tek Pillati me zëmërë po t' i thoj
 se lus kurmin e Krishtit t' e varrsoj.
 Pillati e gjegji e nëng e arnjizoi, 515
 mo se t' e mirrij drej ja përmëtoi.
 E, të shkriqosurë, keq me lipisī
 e shpitin mbrënda ndë një varr të rī.
 Ish nat, e pat mënoj tek ajo shpī
 meruomi Krisht names nd' ata Judhī, 520
 cilit i bëtin straxje e shame i thanë
 aq sa monë ëmërë o nëmërë kanë.
 Pjetri mbero çë nënë i vej të njihij
 çë bëjin e çë thojin e të ndihij,
 ndo mundij gjë, i mbjedhurë pā mbë zjarr 525
 ca gjind e u qas të ngrohej, moj qe marr
 e njohurë daskalerë të Zotit Krisht
 e bën' e je vinxhoi trëmbima e misht,
 se atje ju qas një burr e i thonej: "Ti
 jë daskalerë i tij! Thuoje nani, 530
 çë gjënde prë ndër në!". Pjetri trandaksurë,
 i trëmburë, i ndërliksurë e i tramaksurë,
 të parën herë nje Krishtin arnjizoi
 e gjeli nd' at njëmend një herë këndoi.
 Atje mbero të ngrohej vate arruri 535
 një kriate e, sa rē mbi Pjetrin vuri,
 zuri të thoj: "Kī burr, çë rrī me nē

të ngrohet, mua më duket Ghallillë
e bashk qe me të zënurin". "Ti grua
- përgjegji Pjetri ahiena - s' di çë thua". 540

E gruaja atij: "Të pë e mirë të njoh,
nani ç' afërë të kamë e dreq të shoh.
E folëtë e tënd buftonë se Ghallillë
e daskalerë me të, si qeve, jë!".

Ahiena Pjetëri s' pati mbame më 545
e zū të arnjizoj se faregjë
dij ka shërbesi, e ç' ish ai njeri
kish xënë ndonjë herë, ndo se ji bardh o i zī,
i mirë o i lig kish qënë, e t' rreme tjera
vuri përpara e muori bē prë njera 550
ç' e lanë të vej, moj gjeli nëng qëndroi
e ka të rreme zanjën e lëshoi
të thonej Pjetrit se vërteta ish
sa Zoti Krisht përpara thën' i kish.

E Pjetëri prë të bënë të u metanos, 555
atena iku e jasht me vrap u stros.
Shërbesin ruojti, vrejti e mirë penxoi
e kultuomja ndë zëmrën i thelloi
një shpat dhëmbimi, sa me tharëta lot
qajti sa bëri, prë një gjatith mot, 560
me cilat shumë fëtesën e përlejti
e çë -n- ahiena dreq bardhinë e mbajti.
Fanëmira lot, fanëmira metanī,
çë Pjetrin e ndërroi ndë bardh ka i zī.

Judha mbero s' e pati këtë drit 565
e ka ligu ndë lig më thellë u shpit.
Kurë njohu keq të rënd sijën fëtes,
u metanos, moj nëng kërkoi ndëles.

Muori turrest me k' u kish paguorë
e para Qefallijvet vate u pruerë 570
e me faqen të bënurë si xhapī,
i nxirrepsurë, i turburë e i zī,
"Xani - thërriti - u s' dua këta tures,
çë vëlenjin një gjak të pafëtes,
se keq tue marr këta u i lig mangova 575
e njeriun të dreqtë e tradhizova!".

Po priftrat ju përgjegjtin: "Ti ka na
çë do? Ndo bëre lig, ti bashk me ta
gramisu!". Ahiena Judha i shturi e iku
e ngrah ju sul i pisulluorë armiku. 580

Vate këtu këtë me madh tërbimë,
pa gjeturë jo jatrī e jo pushimë
ndë lavomën ç' e gris e zëen i haj,
si dhia gërrien një lakërë o një mëraj.
Ju ndot se mosnjeri së mën t' e shih, 585

e jo gjitonit më o miqtë i njih.
Ka një burr, ka një grua, ka gjithnjëri
ju duk se meritoj vetëm nodhë.
Gjëmima e trëmbij, qielli e kanosij,
sa i ligu ka një vend ndë një'etërë strosij. 590
Ngjitij një rahj e vej ndë gafarun,
moj pushuome së gjëj a abjend gjakun.
Kudo vej, kudo ruoj, kudo qëndroj,
qellij rrodhënë ç' e grisij e lakoj.
Mbë serpos të dhuroj së mundi më 595
dhëmbimen, ç' e xarrisij pa një gjë
hareje. Sellpizuorë, një lak rrëmbeu,
ndë një' arvurë doq e lidhi e je mbërtheu
ndë qaf, e, si ji llavurë e tërbuorë,
u shtu proposh e si një qenë u vuorë. 600
Pjënxi ju ëj e friturë prana pjasi
i bënurë copa. E Djalli, ç' i dhjavasi
ndë ballë herën e keqe çë t' vëdisij
e me ënda të madhe rrij t' e prisij,
rrëmbierë shpirtin të zī, doq e shtrëngoi 605
ndë krah të zjarrullore, e i kultoi
me një të puthurë pisulluome e keqe
atë me k' shiti Krishtin ndë vëdeqe.
T' arkdhevarkurë ashtu e të nëgjisurë,
bashk të di ndë Pis u pënë gramisurë. 610
Po tradhizorëve një porsimë të gjallë
i lënë, prë t' mbësuomi një sinjallë,
tek cili ndo se ruhet gjithnjëri,
jo rreme bënë, jo lig, jo tradhizi.

FRANCESCO ANTONIO SANTORI

CANTO DELLA PASSIONE

O voi che avete il cuore così tenero,
così mite e credente che spiegarlo
io non posso e non so, se mi ascoltate
con mente aperta e spirito assennato,
una storia racconto che vi avvince 5
lo spirito e la mente. Voglio dirvi
quanto e come patì
per redimerci Cristo e liberarci
dal peccato e dagli inferi, per noi
il cielo spalancando, e quanta gioia 10
celeste ci promise ed al rifulgere
di quella luce quanto l'uomo ottenne.

LA CENA

Cristo, per ripulire il fango umano
dal peccato, tre anni predicò,
empiendo di prodigi e di sapienza 15
cielo e terra, e lo spirito tergeva
con digiuni e diuturne penitenze,
prosternazioni e fervide preghiere.
Poi venne l'ora di lasciare il mondo
per propiziarci la vita celeste. 20
E allora, con la madre, i suoi discepoli
in un luogo raccolse, in assemblea.
I piedi lavò prima a tutti. Disse:
"Il Padre mi ha ordinato di insegnarvi
l'umiltà: ciò che faccio a voi, agli altri 25
dovete farlo, finché esiste il mondo!".
Ma Pietro non voleva,
onde Gesù così l'ammaestrava:
"Chi da me or non vuole essere lavato
rimane peccatore 30
tanto che sarà escluso dal mio regno
né io lo guarderò con dolce affetto".
Pietro, all'udire ciò,
protese il piede e confessò l'errore

dicendo: "Se è così, Signore amabile, 35
lavami come vuoi, ora e per sempre!".
Allora si levò Cristo e con gli altri
si assise per cenare a un'ampia mensa
e benedisse e sacro rese il pane
e, spezzandolo, ad essi si donava 40
dicendo: "Il pane mostra il corpo mio
ed il vino il mio sangue vi rivela.
Se, al cibarvi, vi ricorderete
di me, godrò di gioia in cielo un attimo.
Ora ho pena nel cuore, 45
perché uno di voi mi tradirà".
Gli apostoli dicevano tra loro:
"Un tale oltraggio mai farò al Maestro!".
Cristo riprese a dire e fece intendere
che Giuda era il malvagio pervicace 50
a venderlo disposto,
spinto dall'odio, in combutta col diavolo.
Giuda non si curò, ma dopo il pasto
prese congedo e Cristo come un padre
discorreva sereno con gli apostoli 55
ed a Pietro diceva, il più curioso:
"Per me stasera tutti proverete
vergogna e scapperete come lepri".
Ma gridò Pietro: "Anche se faranno
tutti così, non lo farò, Signore!". 60
E Cristo a lui: "Tu che di più prometti,
mi tradirai stasera per un niente.
E quando per viltà sarai spergiuro,
ricorderà il gallo col suo canto
il mio presagio!". Allora Cristo, alzatosi, 65
prese commiato dalla Madre e solo
con tre s'avviò. Alla misera Madre
sparì la luce e lì nelle lanterne
sangue e volti malvagi ravvisava
e spasmi tenebrosi insostenibili. 70

L'ORTO DEL GETSEMANI

Mentre lei in affanno
restava, Cristo oppresso dall'angoscia
nell'orto del Getsemani arrivò.
Lasciati i tre prescelti
in un posto a pregare, lui, scostatosi 75
alquanto, cadde in ginocchio, e invocò
il Padre per un tratto. Dai discepoli
tornato, in sonno li trovò profondo.

Li riscosse amorevole
 e con dolce rimprovero diceva: 80
 “Su, non dormite! Al peso della carne
 chi diede ascolto ne subì lo scapito.
 Lasciatevi guidare dallo Spirito,
 puri pregate, se volete il bene!”.
 Andò di nuovo ad invocare il Padre, 85
 ma il sonno quei discepoli immaturi
 ancora vinse e quando ritornò
 al vederli ne ebbe dispiacere.
 “Dormite pure – disse, – l’ora è giunta 90
 in cui si abatterà su me la piena,
 ed avrò da soffrire, abbandonato,
 senza gridare o gemere,
 perché tu, Pietro, che hai detto di amarmi
 tanto da non lasciarmi fino in morte,
 ora nemmeno un po’ qui hai potuto 95
 con me pregare, come ti chiedevo”.
 E per la terza volta
 con lunga intensa supplica invocò
 che il Padre dal dolore l’affrancasse
 minaccioso incombente. 100
 Sofferenze provò quindi nell’anima
 così profonde che, sciolto in cruenti
 sudori, cadde con il viso in terra,
 estenuato per manco di sangue.
 Ne provò pena il cielo 105
 e prontamente un angelo mandò
 da cui Cristo ridesto e rinfrancato
 ancora ritornò dai suoi discepoli.
 Addormentati li trovò e scuotendoli
 diceva: “Su, svegliatevi, muovetevi. 110
 Non vedete che già con turba armata
 mi assale Giuda, il rabbioso mastino?”.
 Lo aveva appena detto ed ecco Giuda,
 la faccia nera, apparve.
 “Amico!” disse e l’abbracciò posando 115
 il suo sul di lui labbro.
 Cristo non protestò, soltanto chiese:
 “Che vuol dir questa roba e queste cose
 che mi fai, caro Giuda?
 Mi baci e mi conegni al tradimento?”. 120
 Giuda sguscìo in silenzio, perché aveva
 avvisato i Giudei nel loro Tempio:
 “Chi bacerò, prendetelo, arrestatelo,
 legatelo con cura e rivenite,
 se no, mago com’è, vi gioca un tiro 125
 sfuggendovi di mano come anguilla”.

Quelli, così istruiti, si avventarono
 a gara percuotendolo.
 Gesù non disse più di una parola
 che come tuono gli rombò all'orecchio. 130
 Atterrati, storditi,
 ciechi, tremanti e privi di ragione,
 rischiavano la morte, quando Cristo
 con volto puro e splendido diceva:
 "Con rabbia su di me siete venuti 135
 quasi fossi un acerrimo nemico
 o un ladro ed assassino. Avanti agli occhi
 nella città vi stavo.
 Nei templi, per le strade e nelle piazze
 ho sempre predicato, distogliendovi 140
 dalla colpa, però non mi toccaste,
 e ora più da me che pretendete?
 Ma questa è l'ora vostra, fate pure.
 Son io quel che cercate".
 Ed essi con più rabbia, come cani 145
 bastonati, afferrarono quel puro
 mite agnello che senza un grido o un gemito
 si dava in olocausto.
 Fattosi avanti, uno degli apostoli
 l'orecchio con la spada ad un giudeo 150
 recise, intento a legarlo. Ma spiacque
 a Gesù l'atto e risanò all'istante
 l'organo mozzo, in tono di rimprovero
 volgendosi al violento:
 "Riponete nel fodero le spade, 155
 perché nulla sapete di voi stessi.
 Chi di spada ferisce – ricordate! –
 muore di spada. Mi mancava un fulmine
 per sterminarli, se avessi voluto?
 E il Padre forse non mi manderebbe 160
 schiere angeliche a iosa,
 alla prima parola di richiesta?
 È l'ora dell'Inferno. Se non vado
 io, resta il mondo in distruzione e tenebra.
 Su, lasciateli fare! Vuole il cielo 165
 così". Forte lo strinsero
 i giudei, svicolarono i discepoli
 lasciandolo in balia dei suoi nemici.

NEL PALAZZO DI CAIFA

Strettamente legato e in tutto il corpo
 Gesù per graffi e lividi malconcio 170

portarono i Giudei prima da Anna
 che nera gli scrivesse la condanna.
 Anna non volle e inviò
 Gesù da Caifa, dove, appena giunto,
 da quel gran sacerdote interrogato 175
 fu con cura sul posto:
 “Ma di’, di’ a noi se tu
 sei il Figlio di Dio come dicevi
 ed hanno confermato i testimoni
 or ora in tua presenza”. 180
 A lui Cristo rispose: “Tu l’hai detto
 e io proclamo che voi tra le nubi
 mi vedrete discendere
 con luce e maestà
 per giudicare il buono ed il malvagio 185
 e compensare il padre come il figlio
 e ognuno, come merita,
 mandarlo in paradiso o nell’inferno”.
 Tra gli uomini lì attorno
 stava Malco, parente di colui 190
 cui Gesù, risanandogli l’orecchio,
 bene per male rese.
 Alla retta risposta di Gesù
 Malco reagì con rabbia
 e con mano pesante come il ferro 195
 gli diede un colpo in faccia: “Sei davanti
 al sommo sacerdote
 e rispondi così? Prova a rifarlo
 e rimarrai senza più denti e labbra,
 dato che ogni parola è una bestemmia!”. 200
 E Cristo gli rispose: “Cosa ho fatto?
 Mi meni per avere detto il vero?”.
 Caifa allora furioso si stracciò
 le vesti sbraitando:
 “Che andiamo più a cercare testimoni? 205
 Non avete sentito la bestemmia?”.
 E tutti con un grido ed un pensiero
 risposero: “È maligno e deve andare
 sulla croce a morire, come merita,
 ferito, lacerato, insanguinato!”. 210
 Caifa diceva: “Però non possiamo
 ucciderlo, ché questi sono i giorni
 della Pasqua”. E decisero in consiglio
 come offuscare il giglio
 candido e da Pilato lo mandarono 215
 legato e con un carico d’accuse.

IL PRETORIO DI PILATO

Al vederlo, Pilato
dal viso ne conobbe l'innocenza
e diceva ai giudei: "Ma che volete
da lui? Che ha fatto per trattarlo male?". 220
Risposero: "Ha detto e predicato
dappertutto che un giorno sarà re
e noi per appurare
meglio la cosa, ed ora non è il caso,
gli siamo andati attorno. Ha raccontato 225
d'essere stato inviato giù dal cielo
come maestro e re.
Adesso tu se sia sovrano e Dio
giudica e vedi come sa mentire,
perché noi altro re non conosciamo 230
che Cesare; e nessuno
gli è leale alleato se un altr'uomo
come suo re considera
o a diverso potere s'assoggetta".
A tali detti Pilato s'avvide 235
che volevano ucciso per invidia
il Figlio dell'Eterno e meditò
a lungo la faccenda. Anche la moglie
suggeriva: "Risparmialo, ché giusto
e profeta è quell'uomo avventurato". 240
Le tentò tutte al fine di salvarlo
Pilato, ma la gente urlava: "A morte
il malvagio che merita
tirar le cuoia appeso ad una croce!".

IL PALAZZO DI ERODE

Pilato notò allora che Gesù 245
galileo lo chiamavano e dedusse:
"Se questi è galileo, a me non spetta
condannarlo, ché qui di Galilea
si trova il re". Ciò detto, lo mandò
da Erode che, all'arrivo, 250
lo accolse affabilmente, mentre tutta
accorreva la corte a veder Cristo
ed incontro gli vennero i soldati.
Ma Cristo né parola né saluto
ad Erode rivolse, che per pazzo 255
lo prese, limitandosi ad irriderlo.
Ed al signore tutti si aggregarono
nobili e cortigiani.
Per beffa poi vestitolo di bianco,
a Pilato lo resero. 260

NEL PRETORIO

Nel vederlo conciato in quell'arnese,
così Pilato apostrofò i Giudei:
"Vedete che nemmeno a Erode è parso
degnò di morte e gli ha dato la baia.
Vestendolo di bianco, 265
ne ha rivelato la bontà innocente".
Piena d'odio gridò la folla allora:
"Nulla Erode ne sa, se no tra i vivi
questo ribaldo mai lasciato avrebbe,
mago malvagio, vaso d'impostura!". 270
Pilato, pur confuso ed intontito,
ogni mezzo cercava per salvarlo
e diceva ai giudei: "Sapete, in carcere
abbiamo un assassino che col sangue
si macchiò dei compagni ed in città 275
fece una ribellione. Per la Pasqua
uno va liberato: chi volete,
Barabba o, qui presente, il Nazareno?".
Gridaron tutti: "Libera Barabba,
subito a morte manda il Nazareno!". 280
Pilato, da ogni parte avvolto e stretto
qual mulo impastoiato,
non sapeva avanzare né star fermo
e a Cristo prolungò le sofferenze.
Stabili, per sottrarlo 285
dalle mani di gente che l'odiava,
di dargli coi flagelli una lezione
e rimetterlo poi alla sua sorte.
Rallegrò la proposta quei giudei
e Gesù trascinarono 290
giù nel pretorio vicino alla porta
in tutta fretta e, la seconda volta
spogliatolo, poi, stretto a una colonna
di marmo, che sorgeva in quel cortile,
con funi e corde e tendini robusti 295
lo menarono tanto da sfiancarlo,
ché sul quel puro corpo
infinite percosse scaricarono
imbrattandolo tutto
di sangue dalla testa fino ai piedi. 300
Riportatolo su, lo incoronarono
di spine e gli foraron testa e fronte.
Di rosso rivestito e con in mano
una canna per scettro,
fu bersaglio di schiaffi, 305
sputi, offese, dileggi:

“Indovina, cucù, se sei profeta,
chi t’ha mollato il colpo!”.
E il ginocchio sinistro reclinando
con un palo affondavan la corona. 310

ECCE HOMO!

Nel frastuono assordante
di beffe, botte e grida
corse Pilato e, quando vide Cristo
qual mite bue dilaniato dai lupi,
fu spinto a compatire 315

la vittima di tanta cattiveria.
Si illuse che, mostrandolo così
ridotto, anche le pietre avrebbe smosso.
Gli si accostò, lo prese per un braccio,
lo mostrò da una loggia 320

“Ecco l’uomo - dicendo -
che a morte odiate, mago, Dio, maestro
designandolo e re. Ne avete fatto
un fantoccio inguardabile che a stento
potrà restare in vita. Ora lasciatelo 325
in preda al suo destino!”.

A quella vista il volto celò il sole,
s’intorbì la luna, ma del popolo
non si commosse il cuore
e, qual tempesta e fulmine di monte,
con tuono alto gridò: 330

“Ucciso lo vogliamo, ucciso in croce!”.
“Il vostro re ucciderò?” – diceva
Pilato. Replicarono:
“Non abbiamo sovrano, re e signore 335
che Cesare su noi e, se tu oggi

costui non mandi a morte,
d’essere ligio a Cesare non mostri”.
All’udire Pilato l’avvertenza,
non ebbe voglia e forza di salvarlo,
ma stolido e tremante 340

le mani si lavò davanti a tutti
gridando: “Molta o poca
parte non ho nel sangue che versate.
Questo meschino, giusto ed innocente, 345
in croce muoia, come voi volete!”.

Allora con tumulto prolungato
come quando da balza scroscia un fiume,
gridarono: “Diviso e in gocce sparso,
il sangue suo su noi ricada, acconcio 350

al capo dei presenti e dei futuri
 figli che alla notizia esulteranno".
 Capì Pilato che lottava invano
 e volle porre termine agli strazi.
 Di morte in croce scrisse la sentenza, 355
 come desideravano, in tre lingue:
 "Gesù il Nazareno, dei Giudei
 Re, muoia appeso in croce, come vogliono
 la volontà e la legge degli Ebrei".
 A una lettura attenta 360
 la scritta di condanna non garbò
 a una parte del popolo che insorse
 intimando a Pilato: "No, non scrivere
 'Re dei Giudei' ma chiamalo furfante!".
 Allora finalmente 365
 uscì fuori dai gangheri Pilato
 e ad essi si rivolse inviperito:
 "Più da questo infelice che volete?
 Quello che ho scritto, ben l'ho scritto e niente
 m'importa se sia re, sovrano o principe. 370
 Basta, filate via, non mi seccate
 ronzandomi all'intorno come vespe".

CRISTO SALE AL CALVARIO

Tirarono con l'ascia in fretta e furia
 una croce pesante
 e a Cristo l'accollarono 375
 per portarla penando fino al luogo
 della morte. Il carico gli vinse
 il residuo vigore, e gli spostò
 ossa e nervi, facendolo crollare
 tre volte, come al giogo bue gravato 380
 sfinito e smunto viene giù di schianto.
 Pure, i giudei spietati
 trascinandolo a botte ed a spintoni
 per poco non l'uccisero. Temendo
 però che vivo non giungesse in cima 385
 al monte, come scorsero un viandante,
 Simone il Cireneo,
 ad aiuto forzato lo costrinsero
 fin sul Calvario. Andato un po' più avanti,
 donne dai lunghi pianti a Cristo apparvero 390
 che lo commiseravano. Ma egli
 disse loro: "Non ora
 piangete e non per me. Piangete invece
 per voi stesse e in futuro,

ché tempi giungeranno in cui felici 395
direte senza prole i genitori.
Se sull'albero verde
dan di malvagità questo segnale,
che ne sarà del secco,
che brucia come canna arida e vuota? 400
Implorerete allora: 'Su di noi,
monti, precipitate per schiacciarci!'.
Disse loro e avanzò, ma, stratonato,
cadde ancora. Gridando
come su mulo che stramazzi esausto 405
lo alzarono i giudei a suon di busse.
Un po' più avanti gli si fece incontro
la madre, cui la luce del meriggio
divenne notte fonda nel vedere
così malconco il figlio e trasalì 410
a lui il cuore scorgendo la madre
e per la terza volta
cadde davanti a lei. Subito accorse
la ciurma dei Giudei che non permise
di parlare alla madre, ma furente 415
da lei allontanò
Gesù prossimo a morte. Una signora
ardì, compassionevole, di esporsi.
Forzò la cerchia e apparve
subito avanti a Cristo. 420
Gli terse con un fazzoletto il volto
che lì rimase impresso e la pezzuola
in memoria serbò
Veronica per quanto in terra visse.

IL MONTE CALVARIO

Giunti infine al Calvario 425
lo spogliarono nudo,
sulla croce con astio lo distesero
e poi, senza pietà,
su essa mani e piedi lo inchiodarono,
che ci si chiede come non sia morto. 430
Fu l'amore per gli uomini a tenerlo
vivo e soltanto resse
perché l'amaro calice doveva,
un sorso dopo l'altro, berlo e attingere
il fine che bramava, 435
di riscattare col dolore l'uomo.
Così inchiodato, in alto lo levarono
e l'universo, al vederlo, fremette.

Su essi il sangue come mite pioggia
 si sparse. Allora alcuni dei giudei 440
 le vesti si divisero, ma una,
 inconsutile, fu tirata a sorte
 perché venisse data a chi toccava.
 Si era a mezzogiorno
 quando Cristo gridò che aveva sete 445
 e subito qualcuno dei soldati,
 aceto e mirra mescolò in un vaso
 e dolce e amaro, e in cima
 ad una canna collocò la spugna
 ed alle labbra aride la porse. 450
 L'assaggiò lui appena e non ne volle,
 dei nobili le risa suscitando.
 Con supplica intensissima
 invocò Cristo il Padre: "Eli, Eli,
 perché mi lasci ora, 455
 qui dilaniato e pesto?".
 Si sfibrava Maria con l'altre donne
 presso la croce con somnesso pianto.
 Giovanni aveva al fianco ed, al vederli
 dall'alto della croce, il Redentore 460
 alla Madre diceva: "Ecco tuo figlio!",
 e le mostrò Giovanni e la straziava.
 Poi, voltosi al discepolo, diceva:
 "Ecco tua madre!", e gli mostrò la madre.
 E da allora Giovanni se la tenne 465
 per madre ed in Giovanni a noi fu madre.
 Appesero i giudei con Gesù anche
 due ladroni e di essi
 l'uno al vedere Cristo che soffriva
 innocente si volse a dire all'altro: 470
 "Noi per il male fatto
 è giusto che moriamo adesso in croce.
 Costui invece soffre senza colpa
 e, a quanto dice, muore per salvarci".
 L'altro non volle udirlo e altrove volse 475
 la faccia e il primo prese
 a pregare con fede ardente Cristo
 che gli rispose: "In cielo ti attendo".
 I Giudei, non sapendo più che fare
 per gettare nel niente quella luce, 480
 aizzarono un cieco, che la lancia
 gli ficcò nel costato
 trapassandolo ed oltre la sospinse
 finché rinvenne il cuore e lo trafisse.
 Con una pioggia d'acqua e sangue allora 485
 fu illuminata a lui la cecità

di cuore ed occhi e quando riconobbe
che era il Cristo si pentì, e scaldò
e ravvivò con fede nuova l'anima
e con lui gode in cielo. 490

Allora Gesù Cristo ad alta voce
gridò: "Padre, gli iniqui
assassini non sanno quel che fanno,
onde da te il perdono
meritano: tu non glielo negare. 495

Lieto nelle tue mani
rimetto ora lo spirito!", e nel dirlo
con un grido e un sospiro fragoroso
morì... Violento sisma
scosse montagne, valli, piani e lande, 500
sconvolse il mare e sconvassò la terra
dappertutto. Si tinse per la pena
di nero il sole, la luna di sangue
e l'universo si ammantò di bruno.

Dalle tombe i profeti a quel frastuono
desti, a Gerusalemme s'affrettarono 505
e, morto in croce vedendo il Signore,
stramazzarono a terra
per non levarsi più.

E Gesù, che morendo salvò il mondo, 510
restò due giorni in croce.
Giuseppe e Nicodemo da Pilato
con coraggio si spinsero per chiedergli
di seppellire la salma di Cristo.

Pilato li ascoltò, non si schermì, 515
accordò il suo consenso. Dalla croce
depostolo, pietosi in un sepolcro
nuovo lo tumularono.

Era notte e dovette permanere
Cristo in quella dimora tra i giudei 520
che gli avevano inflitto ingiurie e strazi
smisurati, indicibili.

Pietro però che per curiosità
andava appresso e per aiutare
se in qualcosa poteva, vide gente 525
attorno a un fuoco e si accostò, ma, come
discepolo di Cristo ravvisato,
alla carne soggiacque e alla paura.

Quando un tale incalzavalo: "Tu sei
suo discepolo! Dillo 530
ora che stai con noi!", Pietro tremante,
spaventato, confuso e sbigottito,
negò Cristo ed allora
cantò il gallo una volta.

Non tardò però a giungere una serva 535
 e, squadratolo bene,
 disse: "Quest'individuo che si scalda
 con noi mi sembra galileo ed era
 con l'arrestato". "Tu, donna – rispose -
 non sai quello che dici" 540
 La donna a lui: "T'ho visto e ti conosco,
 ora che ti ho vicino e ben ti vedo.
 E che sei galileo e suo discepolo
 lo dimostra l'accento!"
 Pietro allora non ebbe più ritegno: 545
 si diede a spergiurare che ignorava
 del tutto il caso e se bianco o nero
 fosse quell'uomo, santo o mascalzone.
 Così altre fandonie mise avanti
 con giuramento fino a che permisero 550
 che andasse, ma si prese cura il gallo
 di marcare col canto le menzogne
 e far notare a Pietro che era vera
 la profezia di Cristo.
 E Pietro dell'azione si pentì, 555
 in fretta lasciò il posto.
 Rimuginò la cosa
 e il ricordo nel cuore gli affondò
 una spada crudele, sicché pianse
 a lungo il suo misfatto 560
 e la colpa lavò, sempre serbandosi
 da allora retto e puro.
 Ben augurato pianto e pentimento
 che il misero da nero volse in bianco!
 Giuda privo però di questa luce 565
 nel baratro del male più si spinse.
 Sotto il peso gravoso della colpa
 pentitosi, non implorò perdono.
 Tenendo in mano il prezzo del tradito,
 dai Principi tornò 570
 e, simile nel viso ad un ramarro,
 pazzo, torbido e nero,
 "Tenete – disse – non voglio i denari,
 contropartita d'un sangue innocente,
 perché troppo ho mancato ad accettarli 575
 tradendo l'uomo giusto!"
 I sacerdoti: "Tu - gli replicarono -
 da noi che vuoi? Se hai fatto male, abissati
 con essi!". Giuda li gettò ed uscì
 in balia del demonio. 580
 Andò qua e là con grande turbamento
 senza trovare quiete né rimedio

a ferita che l'anima rodeva
come la capra cavolo o finocchio.
Sentì d'essere a tutti intollerabile, 585
insofferente di amici e vicini.
Null'altro da ciascuno
che odio si attendeva.
Lo spavento del tuono e la minaccia
del cielo lo pressavano a vagare. 590
Saliva un colle, andava in una forra,
ma in alcun luogo requie non trovava.
Tradiva in ogni posto e in ogni sguardo
il rodimento ch'entro lo struggeva.
Infine non poté più sopportare 595
il dolore da cui senza ritegno
veniva tratto. Disperato a un albero
legò una fune e al collo se la strinse.
Poi, idrofobo e pazzo,
sbalzato, restò appeso come un cane. 600
La pancia si gonfiò sì da scoppiare
in mille pezzi. E il diavolo, che in fronte
leggeva la mal'ora della morte
e con gran voglia stava ad aspettarla,
l'anima nera forte a sé l'avvinse 605
tra le braccia di fuoco, con un bacio
infernale chiamando alla memoria
quello con cui venduto aveva Cristo.
Aggrovigliati ed annodati in due
così precipitarono all'inferno, 610
un modello lasciando ai traditori
celebre e inoppugnabile,
guardando al quale evita ciascuno
menzogna, cattiveria, tradimento.

NOTE

Il titolo apposto dal Santori è un generico “Canto” (Kënekë). Manca la traduzione dell'autore.

74. vuri] vëri.

79. namur] namuri. Correzione imposta dalla metrica.

83. Shpirti] Shpirt.

140. aghòra, dal greco agorà. Per l'accento si confrontino *Canzoniere* 8, 121 e *Satire* 9, 13.

159. digjij] digij.

167. Judhijtë] Judhijti.

172. të] thë.

192. ç'] e.

224. më] më.

254. Gioco di parole in albanese: Moj Krishti nëng e fali e nëng i foli. Ho tentato di renderlo con “né parola né saluto”.

257. bashk] bash.

287. frushërë] frushūrë.

292. di] dhi.

309. gjū] gjë.

328. hëna] hjena.

367. nxërr] nxurr.

392. qajni] qajno.

395. shumë] shëmë.

421. Variante. Ju qas, me skamandil çerën i shiti.

427. nxërr] nxurr.

449. vūnë] vë.

500. skotisi] skotise.

536. vuri] vëri.

550. vuri] vëri.

565. këtë] kētu.

591. Ngjitij] Ngijtj.

601. Pjënxi] Pjunxi. *Pjënxi* è la pronuncia del paese natale del Santori. A Frascineto, *pjënsi* (cfr. *Fjalor* del Giordano, *ad vocem*); altrove e nel De Rada, *pjëndësa* (cfr. *Specchio di umano transito*, Napoli 1897, p. 56).